

DEKLARATË PËR SHTYP

Kompania zvicerane MABCO denoncon tentativën për shpronësim dhe bllokimin e paligjshëm të investimit në Aeroportin e Vlorës

TIRANË / LUGANO, 17 JANAR 2026 – Shoqëria zvicerane **MABCO**, zotëruese e **98% të aksioneve** të kompanisë **VIA (Vlora International Airport)**, denoncon publikisht një skemë të mirëorganizuar që synon shpronësimin *de facto* dhe *de jure* të investitorit shumicë dhe paralizimin e një prej investimeve më strategjike në Shqipëri.

Përmes vendimeve të kontestueshme gjyqësore, MABCO-s po i bllokohet çdo e drejtë në shoqërinë ku ajo zotëron pothuajse të gjithë kapitalin, duke krijuar një precedent të rrezikshëm për sigurinë juridike dhe investimet e huaja në vend.

Shkeljet kryesore të evidentuara:

- **Përmbysja e parimeve tregtare:** Në një rast të paprecedent, Gjykata e Shkallës së Parë në Tiranë i ka njohur një aksioneri minoritar (me vetëm 2% të aksioneve) të drejtën për të bllokuar të drejtat, vullnetin dhe vendimmarrjen e aksionerit që zotëron 98% të kapitalit.
- **Arbitrariteti procedural:** Vendimet e gjyqtarëve Fatmir Ndreu dhe Marjana Shegani janë marrë në mungesë të plotë të përfaqësuesve të MABCO-s, pa njoftim paraprak dhe në fshehtësi, duke shkelur parimin e kontradiktorialitetit.
- **Zvarritja e qëllimshme:** Ndonëse vendimi i gjyqtarës Shegani për efektivisht shpronësimin e Mabco-s është dhënë mbi tre javë më parë, pala jonë ende nuk është njoftuar zyrtarisht. Kjo vonesë po përdoret si mjet për të zvarritur procesin e ankimimit në Gjykatën e Apelit.
- **Shpërfillja e hierarkisë gjyqësore:** Pavarësisht se Gjykata e Apelit e rrëzoi më parë vendimin e gjyqtarit Fatmir Ndreu, një vendim pothuajse identik i bazuar në të njëjtat fakte e rrethana është rishfaqur nga Gjykata e Shkallës së Parë vetëm një ditë më pas, duke sfiduar hapur vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit. Kjo përmbysje e hierarkisë gjyqësore, do të përbënte kudo një rast për të hetuar deri në fund motivet që kanë çuar gjyqtaren në shpërfilljen e vendimit të një gjykate më të lartë.

Alarmi për sigurinë dhe kostoja publike

MABCO thekson se ky ngërç artificial ka paralizuar punimet në Aeroportin e Vlorës dhe po rrezikon sigurinë e tij. Për më tepër, siç u vu në pah dhe nga përmblytjet e aeroportit të evidentura nga media ditët e fundit, vijimi i punimeve pa mbikëqyrjen dhe kontrollin e aksionerit shumicë përbën një rrezik serioz për standardet teknike dhe sigurinë e ardhshme të qytetarëve. Ky skenar nuk dëmton vetëm investitorin zviceran, por rëndon drejtpërdrejt mbi qytetarët shqiptarë, të cilët rrezikojnë të paguajnë koston e dështimit të një projekti që duhet të bëhet funksional së shpejti.

Thirrje për ndërhyrje të menjëhershme

MABCO u bën thirrje zyrtare:

1. **Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë** dhe organeve të inspektimit të hetojnë menjëherë motivet dhe procedurat e ndjekura nga gjyqtarët e përfshirë.
2. **Institucioneve shtetërore dhe ndërkombëtare** të ndërhyjnë për të ndaluar këtë tentativë për "plaçkitje" juridike të një investitori të huaj.

MABCO mbetet e vendosur të mbrojë investimin e saj qindra milionë eurosh në të gjitha instancat e drejtësisë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, për të garantuar që ky projekt strategjik të mos mbetet peng i interesave të dyshimta.

Shoqëria MABCO (Lugano, Zvicër) *Aksionere mazhoritare e VIA Sh.P.K.*

*Zyra për komunikim dhe media
Mabco Constructions SA*

Bashkëlidhur, vendimi i Gjykatës së Apelit